



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 5, datë 10.07.2020

“Për një ndryshim në vendimin nr. 1, datë 08.02.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për miratimin e rregullores së brendshme për funksionimin e Këshillit për Emërime në Drejtësi”, i ndryshuar

Në mbështetje të pikës 1, të nenit 230, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 1, datë 08.02.2019 të Këshillit për Emërime në Drejtësi “Për miratimin e rregullores së brendshme për funksionimin e Këshillit për Emërime në Drejtësi”, i ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Neni 1

Në nenin 16, në pikën 12, fraza “Kryetari i Këshillit” shfuqizohet dhe shtohet fjalia me përmbajtjen si vijon:

“Kryetari i Këshillit shpreh qëndrimin dhe voton i fundit.”.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në pjesën e caktuar për Këshillin për Emërime në Drejtësi.

ZËVENDËSKRYETARE

Vitore Tusha